

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Vullneti / *el-Iraade* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"قُلْ كُلُّ يَعْمَلُ عَلَىٰ شَاكِلَتِهِ"

“Thuaj: Çdokush vepron sipas prirjes së vet.” (el-Israa, 84)

Vullneti është një nga rregullat parimore të kësaj dijeje dhe është një nga strukturat themeltare të saj.¹ Kjo ka të bëjë me reagimin e vullnetshëm ndaj thirrjes të së vërtetës.² Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë ka të bëjë me:

- Lënien e shprehive duke iu kushtuar dijes.³
- Qëndrimin pranë frymëmarrjeve të udhëtarëve në shtegun e pastrimit shpirtëror, me devocion ndaj nijetit.⁴
- Heqjen e të gjitha shpërqendrimeve që vijnë nga vëllezërit dhe vendlindjet.

Niveli i dytë arrihet me anë të:

- Shoqërisë së gjendjes shpirtërore (*haal*)⁵

¹ Vullneti është të vepruarit parimor të zemrës. Prandaj dhe kjo ka një vend të rëndësishëm në shkencat sufizmit, të cilat përqendrohen në punën e zemrës, në prirjet dhe në veprimet e saj.

² Kjo ka të bëjë me prirjen origjinale të zemrës. Ndryshe nga vendosmëria, ku njeriu mund ta detyrojë vetveten të silllet në një mënyrë të caktuar, kjo ka të bëjë me anim të vullnetshëm për krijuesin.

³ Ti braktis prirjet dhe preferencat e tua personale e shoqërore për t’iu përmbajtur kërkesave të Shpalljes sapo t’i mësosh ato.

⁴ Të shoqërohesh me udhëtarët e shtegut të pastrimit shpirtëror ndërsa sigurohesh që zemra jote i është drejtuar vendmbërritjes së njëjtë (si të atyre).

- Rigjallërimin me anë të intimitetit rehatues (*uns*) me Zotin.
- Ecjes mes gjendjeve të ngushtësisë dhe gjerësisë.⁶

Niveli i tretë është ekstaza me kushtim ndaj ndershmërisë dhe ndaj vëmendjes ndaj përpunimit të karakterit.⁷

⁵ Mos humb çfarëdo artikulli shpirtëror që Allahu ta dhuron (p.sh. ndonjë mbështetje e shtuar në Allahun, që të vjen përnjëherë; ose ndonjë kënaqësi e shtuar me caktimin e Allahut, e gjendje të tjera si këto).

⁶ Këto dy gjendje të *inbisaat* (rehatisë, qetësisë, dashamirësisë) dhe të *inkibaad* (shqetësimin, tensionimit, rezervimit) rezultojnë nga ndërrimi i shpresës dhe frikës, afërsisë dhe largësisë; ose thjesht mund të shkaktohen nga Allahu për ta përsosur sprovën e Tij, siç tha 'Ataa: "Ai të zgjeroi që të të mos mbajë në ngushtësi; Ai të ngushtoi që të të mos mbajë në gjerësi; dhe Ai të nxori nga të dyja këto gjendje, që ti të mos i përkasësh asgjëje dhe askujt tjetër veç Tij." Një rob i vërtetë do të vazhdojë të ecën mes këtyre gjendjeve pa u bërë i pashpresë në gjendjet e ngushtësisë dhe pa u ngazëllyer në gjendjet e gjerësisë. Allahu tha: "Me qëllim që të mos dëshpërohesh për atë që ju ikën dhe të mos ngazëllesh (në krenari) për atë që Ai ju jep." (el-Hadid, 23).

⁷ Kjo është ekstaza që të shpërqendron nga kjo botë, por jo dhe nga Zoti yt. Është një ekstazë që nuk të devijon nga ndershmëria e drejtësia ose nuk të bën të dështosh në zbatimin e etiketës së mirësjelljes me krijesat dhe krijuesin e tyre.